



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 264, Datë 14.10.2022

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2022, mbasi shqyrtoi me relacionin nr. 1799/4 prot., datë 12.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “Construction Energy Parts” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1748 prot., datë 03.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të

energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).

- Aplikuesi ka depozituar për llogari të ERE një shumë më të madhe sesa pagesa e aplikimit e përcaktuar në Aneksin A, të rregullores së licencimit, ndaj në të tilla rrethana, pagesa shtesë do t'i kthehet.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Construction Energy Parts” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pikës 1.1, gërmave “a”, “b” dhe “c”; pikës 1.2, gërmave “a” dhe “d”; pikës 1.3, gërmave “b” dhe “c”; pikës 2.1, gërmave “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”. Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se mungon dokumentacioni si vijon:

Neni 9, Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të përcjellë në ERE me datë të rifreskuar vërtetimin e gjendjes gjyqësore për administratorin e shoqërisë, pasi mban datë më të hershme sesa ajo e parashikuar në nenin 8, pika 3 të rregullores së licencimit. Po ashtu duhet të përcjellë në ERE edhe Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore për vetë shoqërinë “Construction Energy Parts (C.E.P) sh.p.k.
- **gërma “c”:** Referuar kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores, shoqëria duhet të përcjellë informacion nëse disponon staf të mjaftueshëm në funksion të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimin e detyrimeve tatimore me datë të rifreskuar, pasi mban datë më të hershme se ajo e parashikuar në nenin 8, pika 3 të rregullores së licencimit. Po ashtu konstatohet një detyrim i pashlyer ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, shoqëria duhet të përcjellë edhe vërtetimin për sigurimet shoqërore e shëndetësore me detyrimin e shlyer.
- Në lidhje me dokumentacionin e konstatuar të munguar, do të njoftohet shoqëria ta përcjellë atë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Construction Energy Parts” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI